



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 352/2014

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Muhamet Rexha kryesues, Ferit Osmani dhe Rafet Haxhaj anëtarë, duke vendosur përkritazi me ankesën e Ismet Osmanit nga Prishtina, për shkak të parregullsive në qendrën e votimit, për Zgjedhjet e Parakohshme Parlamentare, në seancën e panelit të mbajtur me dt.12.06.2014. mori këtë:

VENDIM

Hidhet si e pasafatshme ankesa e Ismet Osmanit nga Prishtina .

Arsyetim

Me datë 11.06.2014 ora 17:20 PZAP-i, ka pranuar një ankesë nga Ismet Osmani nga Prishtina, në të cilën ka pretenduar se në zgjedhjet parlamentare të mbajtura me dt. 08.06.2014 ka pasur parregullsi gjatë procesit të tij të votimit. Parashtruesi i ankesës ka theksuar se ka votuar tek fakulteti ekonomik rreth orës 11:35-11:40, mirëpo vota e tij është konsideruar e pavlefshme dhe i është fshehur, andaj në ankesën e paraqitur kërkon të dijë kush dhe pse ja ka fshehur votën.

PZAP-i, pasi që shqyrtoi afatshmërinë e ankesës gjeti se:

ankesa është e pasafatshme

PZAP-i, nga shkresat e lëndës konstatoi se ankesa është e pasafatshme ngase afati për të parashtruar ankesë në PZAP, është përcaktuar me nenin 119.1 të LZP-së, në të cilin parashihet se: *“Personi i cili ka interes ligjor në një çështje brenda juridiksionit të PZAP-it, ose të drejtat e të cilit janë shkelur për sa i përket procesit zgjedhor të rregulluar sipas këtij ligji ose rregullave zgjedhore, mund të paraqes ankesë PZAP-it, brenda 24 orëve nga momenti i mbylljes së qendrës së votimit”*, ndërsa ankesa në PZAP është dorëzuar me datën 11.06.2014 në ora 17:20, çka nënkupton se ka kaluar afati i paraparë prej 24 orë për dorëzimin e ankesës në PZAP. Andaj PZAP-i, në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, lidhur me ankesën e lartpërmendur vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli zgjedhor për ankesa dhe parashtresa

Anr. 352/2014 më datën 12.06.2014

Kryesuesi i Panelit
Muhamet Rexha



Këshillë Juridike: PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i.*